



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.03/2019

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët, Armend Berisha, kryetar, Manushe Karaqi dhe Anita Krasniqi Prenaj, anëtarë të Komisionit, në procedurë disiplinore ndaj Xxxxx Xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxxxx, sipas Raportit Përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2018-229, në procedurë të Komisioni Disiplinor i KGJK-së ka marrë numrin KGJK/KD/03/2019, për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2 dhe shkelje e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së Hasime Osmani, dhe gjyqtarit Xxxxxx Xxxxxxxx, më datë 06.06.2019, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Xxxxxxxx Xxxxxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxxxx, **është** përgjegjës për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2018-229.
2. Për shkak të vërtetimit të sjelljes së pahijshme, gjyqtarit Xxxxxx Xxxxxxxx i shqiptohet masa disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për tridhjetë (30%) në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, duke filluar prej muajit në vijim pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Komisioni Disiplinor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka pranuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor Raportin Përfundimtar me numër ZPD-2018-229, se bashku me shkresat e lëndës, me të cilin e ka ngarkuar Xxxxxxxx Xxxxxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxxxx për sjellje të pahijshme të përcaktuara në nenin 34 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Hetimin disiplinor Zyra e Prokurorit Disiplinor e kishte filluar në bazë të një denoncimi të pranuar nga Xxxxxxxx Xxxxxxxx ndaj gjyqtarit Xxxxxx Xxxxxxxx duke pretenduar se janë bërë nëntë (9) vite nga dita e padisë së parë dhe çështja ende nuk ka marr epilogun ligjor. Fillimisht ZPD ishte njoftuar se lënda është pranuar në vitin 2014 në Gjykatën Themelore në Xxxxxxxx dhe me të njëjtën lëndë ishte ngarkuar gjyqtari Xxxxxx Xxxxxxxx. Nga viti 2014 deri në vitin 2017 gjyqtari Xxxxxx nuk kishte ndërmarr asnjë veprim. Veprimin e parë e kishte ndërmarr pas tri (3) vite dhe ai veprim ka qenë vendim me kërkesë për pagesë të taksës gjyqësore nga pala paditës. Të gjitha seancat tjera të caktuara nga ana e gjyqtarit Xxxxxx, sipas hetimit të ZPD-së janë shtyrë për arsyeje të ndryshme.

ZPD po ashtu ka konstatuar se në momentin kur pala ka konstatuar qe janë kaluar të gjitha afatet kishte paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit. Këtë kërkesë për përjashtim e kishte miratuar kryetari i Gjykatës Themelore në XXXXXXX dhe lëndën ja kishte ndarë gjyqtarit tjetër te të njëjtës gjykatë i cili kishte vazhduar me shqyrtim. ZPD ka konsideruar se një zvarritje prej 3-4 vite është neglizhencë nga ana e gjyqtarit XXXXXXX, dhe ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor inicimin e procedurës disiplinore.

Gjyqtari XXXXXX XXXXXXXX, në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur me datë 06.06.2019 ka deklaruar se i vjen shume keq qe ndodhet para Komisionit Disiplinor sipas denoncimit të një kolege. Në fillim gjyqtari ka pasur vërejtje për shkak të mungesës se disa provave në raportin e ZPD-së, ti cilat prova gjatë seancës ja ka dorëzuar Komisionit dhe përfaqësueses se ZPD-së. Ka theksuar së lënda kontestuese C.nr.137/2010, si padi është paraqitur në Gjykatën Themelore në XXXXXXX dhe bazuar në vendimin e Gjykatës se XXXXXX, ishte përcjellë në Gjykatën Themelore në XXXXXXX, nga mesi i vitit 2014. Ka theksuar se në këtë kohë i është thënë gojarisht në Gjykat, që është edhe një lëndë tjetër dhe qe ai duhet ta pres këtë lëndë, në mënyrë qe pastaj të bëjë bashkimin e lëndëve. Kjo lëndë për të cilin sipas gjyqtarit ishte përfolur se do të vij nga Gjykata Themelore në XXXXXX, ishte pranuar në Gjykatën Themelore në XXXXXXX në vitin 2017. Sipas gjyqtarit XXXXXX nuk qëndron pretendimi i ZPD-së se ai nuk kishte ndërmarr asnjë veprim nga viti 2014 deri në 2017, kishte caktuar disa seanca, mirëpo për arsye të ndryshme ishin shtyrë.

Me datë 23 shkurt 2018 është mbajtur shqyrtimi dhe ishte bërë bashkimi i lëndës C.nr.1370/2010 dhe C.nr.3172/12. Seanca e datës 09 mars 2018, nuk ishte mbajtur me kërkesën e të autorizuarit të palës së paditur, ndërsa seanca gjyqësore e datë 05 prill 2018 është mbajtur dhe është vendosur për nxjerrjen e ekspertizave të psikiatrisë dhe psikologjis. Me datë 25 tetor 2018, kryetari i Gjykatës Themelore në XXXXXXX e kishte aprovuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit XXXXXX XXXXXXX dhe për udhëheqje të procedurës dhe vendosje të lëndës C.nr.627/14 ishte caktuar një gjyqtar tjetër.

Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e ZPD-së theksoj se në bazë të deklarimit të vetë gjyqtarit në seancë, bazuar shkresat e lëndës dhe raportin përfundimtar të ZPD-së edhe një herë vetëm se u dëshmuar neglizhencë nga ana e gjyqtarit XXXXXXX në trajtimin e lëndës kontestuese. Nga viti 2014 kur gjyqtari e kishte pranuar lëndën e deri në veprimin e parë kur e ka ndërmarr në këtë çështje kishin kaluar me tepër se tre (3) vite. Veprimin e parë qe e kishte marr pas tri viteve ka qenë vendimi për pagës të taksës gjyqësore dhe prapë kishte kaluar gati një (1) vitë kur ishte filluar i shqyrtimit i lëndës kontestuese.

Ndërsa, gjyqtari XXXXXXX në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk qëndron pretendimi i ZPD-së dhe sipas tij ai ka bërë përpjekje maksimale, intensive për të përfunduar këtë lëndë, mirëpo kur janë bërë gjitha kushtet, situata ka eskaluar qe ai nuk e ka ditur motivin, dhe për keqardhje është bërë ky denoncim.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provat në shkresat e lëndës si: informacionin apo përgjigjen me shkrim lidhur me lëndën Cnr.627/14 e ZPD-së, të prokurores disiplinore znj.Hasime Osmani, të datës 23.04.2019, bërë nga gjyqtari XXXXXX XXXXXXX nga Gjykata Themelore në XXXXXXX, një email apo komunikim elektronik ndaj gjyqtarit dhe prokurores i datës 25 prill 2019, kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e parashtuar nga XXXXXXX XXXXXXX, drejtuar ZPD-së 08.10.2018, deklarata drejtuar kryetarit të Gjykatës Themelore XXXXXXX, XXXXX XXXXXXX nga gjyqtari XXXXXX XXXXXXX e datës 19.10.2018 në lëndën Cnr.627/14. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit XXXXXX XXXXXXX nga shqyrtimi i rastit Cnr.627/14, bërë nga paditësja XXXXXXX XXXXXXX, e datës 12.10.2018 drejtuar

kryetarit të Gjykatës Themelore XXXXXXXX. Një kërkesë për informatë e kryetarit të Gjykatës Themelore XXXXXXXX drejtuar gjyqtarit XXXXXXXX XXXXXXXX, e datës 30.07.2018, lidhur me lëndën Cnr.627/14. Një parashtrësë e titulluar Informatë, drejtuar kryetarit të Gjykatës Themelore XXXXXXXX, nga gjyqtari XXXXXXXX XXXXXXXX, e datës 02.08.2018. Aktvendimi i Gjykatës Themelore XXXXXXXX, evidentuar me shenjën GJA,nr.1/18-87, e datës 25.10.2018 e kryetarit të Gjykatës Themelore XXXXXXXX, ku është aprovuar kërkesa e paditëses për përjashtimin e gjyqtarit nga shqyrtimi i këtij rasti. Një kopje e padisë e parashtruar nga paditësja znj.XXXXXXXX XXXXXXXX, kundër te paditurës “XXXXXXX XXXXX”, e datës 05.12.2012. Procesverbal mbi pranimin e lëndëve për muajin korrik 2014, ku konstatohet se gjyqtari XXXXXXXX XXXXXXXX me datë 01.08.2014 ka pranuar edhe lëndën Cnr.627/14.Letër konfirmim i datës 26.10.2018, ku thuhet se rasti në fjalë i është ndarë gjyqtarit XXXXXXXX me datë 25.07.2014 sipas konfirmimit të të lëshuar nga sistemi SMIL që praktikohet tani, një komunikim elektronik përmes emailit të bërë nga z.Bekim Telaku, e datës 15.10.2018 drejtuar ZPD-së, për grumbullimin e informatave. Një procesverbal i seancës përgatitore i datës 05.04.2018, Cnr.627/14, procesverbal i seancës përgatitore i datës 09.03.2018, Cnr.627/14, një tjetër procesverbal i seancës përgatitore i datës 03.02.2018, Cnr.627/14, procesverbal i seancës përgatitore i datës, 30.01.2018, Cnr.627/14, procesverbal i seancës përgatitore i datës, 21.12.2017, C.nr.627/14, procesverbal i seancës përgatitore i datës, 21.11.2017, Cnr.627/14, procesverbal i seancës përgatitore i datës, 29.06.2017, Cnr.627/14 dhe se të gjitha këto procesverbale i referohen Gjykatës Themelore XXXXXXXX. Procesverbal i seancës së shkallës së dytë, i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me shenjën P.1350/10, i datës 15.10.2012, i trajtuar nga gjyqtarët e EULEX-it, është lexuar padia për kompensim të demit moral - jo material, për shpifje dhe fyerje për gjatë vitit 2011-2012, ushtruar nga paditësja XXXXXXXX XXXXXXXX, kundër te paditurës XXXXXXXX, e datës 15.12.2012, mandej Aktvendim i datës 23.02.2018, me shenjën Cnr.627/14, me të cilin të paditurës i është dërguar aktvendimi së bashku me provat dhe përgjigjen në padi është lexuar Aktvendim i datës 23.02.2018 me shenjën Cnr.627/14, me të cilin aktvendim bashkohet procedura në çështjen juridiko – kontestimore, ashtu qe nga dy lëndët e ndara të cilat ekzistojnë në punë si Cnr.1370/10 dhe Cnr.1372/12 e evidentuar në Gjykatën Themelore në XXXXXXXX, krijohet vetëm një lëndë në këtë gjykatë, e cila do të mbajë numrin e përbashkët Cnr.627/14. Madej është vazhduar në leximin e Aktvendimit ku është urdhëruar qe ekspertit ti paguhet shuma në emër të shpërblimit i datës 18.10.2018, me shenjën Cnr.627/14, parashtrësë e të paditurës drejtuar Gjykatës Themelore me datë 16.04.2018, e titulluar parashtrësë mbi njoftimin e gjykatës, njoftim i lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës mbi shuarjen e biznesit, i datës 26.05.2016, autorizim i dhënë nga paditësja për avokatin z.Besnik Berisha. Një kopje e padisë e parashtruar në Gjykatën e XXXXXXXX, nga paditësi z.Artan Gurizi nga XXXXXXXX, kundër te paditurës D.P.H “La Pizza”, Aktvendim i Gjykatës Themelore XXXXXXXX i datës 20.01.2017, me shenjën Cnr.1302/16, ku është lëshuar urdhër pagesa, këtu është fjala për 5-6 lëndë qe janë marr si mostër nga ZPD, ku se bashku me ato janë kopjet e padive dhe vendimet gjyqësore me të cilat prokurori disiplinor pretendon se ju kenë kryer raste më të reja se rasti për të cilën është iniciuar procedura për shkak të zvarritjes. Po ashtu lexohen edhe gjitha raportet statistikore qe përfshihen periudhat kohore, vitin 2015-2016-2017.

Sipas vlerësimit të Komisionit, qëndron pretendimi i Zyrës se Prokurorit Disiplinorë se gjyqtari XXXXXXXX ka neglizhuar trajnimin e lëndës konkrete C.nr.627/14 dhe me këtë veprim ka diskreditua figurën e gjyqtarit dhe ka dëmtuar imazhin e sistemit gjyqësore. Deri të gjendja e vërtetuar si me lartë Komisioni erdhi pas analizimit të provave të administruar në seancën dëgjimore, e të cilat i vlerëson të besueshme por edhe nga vetë deklaramit i gjyqtarit i cili ishte subjekt i kësaj procedure.

Bazuar në provat qe janë në shkresat e lëndës dhe nga deklarimi i vetë gjyqtarit XXXXXXXX në seancë dëgjimore, ai lëndën konkrete e kishte pranuar me datë 25 korrik 2014 dhe me këtë lëndë ka qenë

i ngarkuar deri me datë 26 tetor 2018, kur e njëjta lëndë i ishte ndarë gjyqtarit tjetër pas kërkesës se ankuesit për përjashtim. Kërkese të cilën e ka aprovuar Kryetari i Gjykatës Themelore në XXXXXXXX.

Sipas raporteve statistikore që janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, gjyqtari XXXXXXXX në vitin 2015 nga 212 lëndë sa i kishte kryer, prej tyre 60 kanë qenë lëndë të cilat në të njëjtin vit i ka pranuar por edhe i ka përfundua.

Po ashtu në vitin 2016 nga gjithsej 197 lëndë të kryera prej tyre 54 lëndë kanë qenë të njëjtit vite që janë pranuar dhe i ka përfunduar, kurse në vitin 2017 nga 213 lëndë të përfunduara 121 lëndë kanë qenë po ashtu të njëjtit vit të pranuar dhe të përfunduar. Vlen të theksohet se këto lëndë të përfunduar ndër vite kanë qenë të natyrave të ndryshme por edhe lëndë që nuk gëzojnë prioritete as sipas ligjit dhe Strategjisë së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për reduktimin e lëndëve të vjetra.

Kështu që, sipas vlerësimit të Komisionit gjyqtari është përgjegjës për neglizhencë në trajtimin e lëndës C.nr.627/14, për të cilën nga data 25 korrik 2014 kur ishte ngarkuar e deri me 01 shkurt 2017 kur kishte ndërmarr veprimin e parë, vendim për kërkesë për pagesën të taksës gjyqësore, kishin kaluar dy vite e gjashtë (2.6) muaj. Është jo serioze nga ana e gjyqtari që të bazohet në deklaratat jo zyrtare dhe të zvarrit lëndën duke pritur edhe pranimin e lëndës tjetër nga gjykata e XXXXXX në mënyrë që të bëjë bashkimin e lëndëve, sepse në rastin konkret nuk ka pas kërkesë nga palët që mos të caktohet seanca por të pritët dhe me vonë të bëhet bashkimi për shkak të ekonomizimit të procedurës apo trajtimit të njëjtë. Madje nuk ka pas as dilema nga vetë gjyqtari, se në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje të cilat mund të vlerësohen si pengesa procedurale që i referohen gjyqe varësisë apo diçka të ngjashme.

Arsyetimi i gjyqtari se lënda ka qenë shumë komplekse dhe sensitive është në tersi në kundërshtim me natyrën e punës së gjyqtarit, sepse kompleksiteti i çështjeve dhe ndjeshmëria presupozohen sepse është gjyqtar, andaj arsyetimi i gjyqtarit për mos të caktuar seancën është i pa vend dhe shqetësuese.

Shtyrja e vendosje është në kundërshtim edhe me nenin 2 pika 2.3 të LPK-së. Ku thuhet se Gjykata nuk mund të refuzojë shqyrtimin dhe vendosjen mbi kërkesat që janë në kompetencën e saj.

Komisioni deklarimin e gjyqtarit se pala ankuese e ka kërcënuar gjyqtarin me fjalët, në një nga seancat e caktuara, por që nuk është mbajtur, se si e paditura në atë rast që ka dëmtuar paditësen dhe ja ka nxire jetën, do të ja bëjë njëjtë edhe atij, kjo thjesht nga Komision është vlerësuar vetëm si përpjekje për të vështirësuar vendimmarrjen dhe për ta vënë në presion. Komisioni edhe në rastet kur ka në procedurë anëtarët saj vepron, dhe konform të gjeturave pa përjashtim vendos varësisht nga shkelja, dhe ka raste kur është veprua. Gjyqtari në pyetjen e Komisionit se a e ka raportuar këtë rast të organet përkatëse, ai është arsyetuar se kinse nuk bënë kërkesa kundër kolegeve të vetë, atëherë shtrohet pyetja se para kujt e zbuloj apo raportoj kinse atë kërcënim dhe pse e priti seancën dëgjimore për ta thënë këtë.

Në seancën për këshillim dhe votim, Komisioni njëzëri vendosi së gjyqtari XXXXXXXX XXXXXXXX është përgjegjës për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, dhe shkelje e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Lidhur me këtë konstatim, Komisioni në mënyrë unanime i shqipton masën disiplinore **Ulje e përkohshme e rrogës për 30% në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve**, duke filluar prej muajit të ardhshëm pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.3 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.03/2019, datë 06.06.2019

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Armend Berisha

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Skender Çoçaj, kryesues i KGJK-ës;
- ZPD-së;
- XXXXX XXXXXXXX, kryetar në Gjykatën Themelore në XXXXXXXX;
- XXXXXXXX XXXXXXXX, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në XXXXXXXX;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;
-